



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

Nr. 1577/Prot.

Tiranë, më 01.10.2025

VENDIM

Nr. 47, datë 01.10.2025

PËR
PROPOZIMIN PËR MIRATIMIN E KRITEREVE TË VLERËSIMIT TË
KANDIDATËVE PËR PERSONELIN AKADEMIK ME KONTRATË ME
KOHËZGJATJE TË CAKTUAR DHE ANGAZHIM ME KOHË TË PJESSHME, NË
UNIVERSITETIN E ARTEVE, PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në nenin 3, pika 4, gërma “ç” si dhe në nenin 38 të ligjit nr. 80, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 24 të Statutit të Universitetit të Arteve, pasi shqyrtoi dhe diskutoi mbi materialin me nr. 1577 prot., datë 30.09.2025, të përcjellë nga Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore SJI/P-A për miratimin e kriterëve të vlerësimit të personelit akademik me kontratë me kohëzgjatje të caktuar dhe angazhim me kohë të pjesshme, me votim të hapur,

VENDOSI:

1. Propozimin për miratimin e kriterëve të vlerësimit të kandidatëve për personelin akademik të me kontratë me kohëzgjatje të caktuar dhe angazhim me kohë të pjesshme, në Universitetin e Arteve, për vitin akademik 2025-2026, sipas materialit bashkëngjitur.
2. Ky vendim t’i dërgohet për miratim Bordit të Administrimit të Universitetit të Arteve.
3. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve dhe tek transparenca.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Dr. Erald Bakalli

Prof. Najada Hamza

Prof. Arben Llozi

Prof. Miltiadh Kutali

Prof. Sadik Spahija



Prof. Lorenc Radovani



Prof. Vladimir Myrtezaj (Groscha)

Prof. Endri Sina



Prof. Rudina Ciko



Prof. Gazmend Gjoka



Prof. Asoc. Dorian Çene



Prof. Asoc. Albes Fusha



Prof. Asoc. Edmond Gjikapulli




Prof. Asoc. Kristina Laço

Prof. Asoc. Genci Fuga




Prof. Asoc. Alert Çeloaliazj



Prof. Asoc. Orion Shima

Enea Trimi (Student FAB)



Rei Kita (Student FM)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE

REKTORATI

DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE JSIP-A

Nr. 1577 Prot.

Tiranë, më 30.09.2025

Lënda: Kriteret e vlerësimit të kandidatëve për personel akademik me kontratë me kohëzgjatje të caktuar dhe me angazhim me kohë të pjesshme, në Universitetin e Arteve, për vitin akademik 2025-2026

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ligjin Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës” i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, në Statutin e Universitetit të Arteve, përcjell kriteret e aplikimit për personel akademik me kontratë me kohëzgjatje të caktuar dhe me angazhim me kohë të pjesshme, për vitin akademik 2025-2026. Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme dhe t’i dorëzojnë dokumentat përkatëse pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në UART, sipas nevojave që UART ka për personel akademik me kontratë me kohëzgjatje të caktuar dhe me angazhim me kohë të pjesshme, për vitin akademik 2025-2026.

Përzgjedhja e personelit akademik të ftuar në UART realizohet nëpërmjet konkurrimit, sipas kërkesave të fakulteteve të Universitetit të Arteve si dhe mbështetur në legjislacionin përkatës për këtë qëllim.

I. Dosja që do të dorëzojë kandidati, duhet të përmbajë, dokumentat si më poshtë:

1. Jetëshkrimin (CV)
2. Fotokopje e ID;
3. Dëshminë e gjuhës së huaj të noterizuar;
4. Dëshminë/vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
5. Dëshminë mjeko-ligjore;
6. Të zotërojë diplomë të ciklit të dytë të studimeve Master, ose diplomë të sistemit të vjetër 4-vjeçar.
 - a. Të jenë diplomuar në specialitetin dhe fushën përkatëse në sistemin me kohë të plotë brenda ose jashtë vendit, sipas kërkesave të Njërive Bazë.
Përparësi do të kenë kandidatët që kanë diplomë në fushën e artit.
 - b. Kandidati/tja, e diplomuar jashtë vendit, duhet detyrimisht ta kenë të njehsuar diplomën në MASR;
7. Konkurrentët që janë mbajtës të titullit akademik “*Profesor*” apo “*Profesor i Asociuar*” dhe që janë bashkëpunëtorë në kohështrirje me fakultet e Universitetit të Arteve, do të kenë përparësi.
8. Të gjithë konkurrentët të cilët nuk kanë Titull akademik apo gradë shkencore duhet ta kenë ***notën mesatare të shkollës së lartë mbi 8.***
9. Eksperienca e mëparshme në mësimdhënie në UART apo në universitete të tjera brenda vendit, apo në universitete jashtë vendit. Kjo duhet të provohet me vërtetime zyrtare të lëshuara nga institucionet përkatëse dhe të njohura/ekuivalentura sipas legjislacionit shqiptar.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

10. Dy rekomandime nga staf akademik i Universiteti/Fakulteti ku kandidati ka kryer studimet, me titull “Profesor” ose “Prof. Asoc”;

11. Leje me shkrim nga titullari i institucionit/kompanisë ku është i punësuar, që lejon angazhimin e kandidatit në mësimdhënie si pedagog i jashtëm në UART për vitin akademik 2025-2026.

II. Skeda pikëzuese e vlerësimit të dosjeve të kandidatëve do të përmbajë këto fusha kryesore:

a. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret artistike profesionale:

- | | |
|--|--------------|
| • Doktor brenda vendit | 0-10 pikë |
| • Doktor jashtë vendit | 0-15 pikë |
| • Tekst mësimor i botuar. | 0-5 pikë |
| • Artikull/artikuj shkencorë të botuara brenda vendit, | 0-5 pikë |
| • Artikull/artikuj shkencorë botuar jashtë vendit, | 0-5 pikë |
| • Çdo 1 vit pune në mësimdhënie në specialitetin për të cilin konkurren vlerësohet me 1 pikë. | 0-10 pikë |
| • Diploma Bachelor/Master i Shkencave, në UART ose jashtë shtetit (me ekuivalencat përkatëse në MAS) sipas formimit të kërkuar specifik. | 0 - 10 pikë; |
| • Certifikata e mbrojtjes së gjuhës së huaj. | 0 - 10 pikë; |

b. Interpretime dhe vepra artistike etj.

- | | |
|--|-----------|
| • Aktivitete artistike individuale | 0-15 pikë |
| • Vepra të vëna në skena prestigjioze, koncerte solistike, ekspozita individuale, etj. | 0-15 pikë |
| • Pjesëmarrje kolektive në aktivitete artistike brenda vendit | 0-10 pikë |
| • Pjesëmarrje kolektive në aktivitete artistike jashtë vendit | 0-10 pikë |

V.O.

Dosja e secilit prej konkurrentëve për personel akademik me kontratë me kohëzgjatje të të caktuar dhe me angazhim me kohë të pjesshme, do të vlerësohet në maksimalen e saj me 120 pikë.

Këto kritere hyjnë në fuqi për konkurset që do të zhvillohen për personel akademik me kontratë me kohëzgjatje të të caktuar dhe me angazhim me kohë të pjesshme, me miratimin në *Senatin Akademik*.

Dr. MBNJ

Meris XIBRAKU

